

**UDHËZIM**  
**Nr. 11, datë 15.6.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 11.2.2022,  
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË  
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6 dhe nenit 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”; të pikës 5, të VKM-së nr. 101, datë 9.2.2022, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2022”, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

**UDHËZOJNË:**

Në udhëzimin nr. 1, datë 11.2.2022, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në pjesën hyrëse “Përkufizime”, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. “Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve” është komisioni i ngritur në AZHBR për vlerësimin e aplikimeve për masën 8 dhe 9.”.

2. Në kreun VIII “Kriteret, aplikimi dhe dokumentet e nevojshme për masat 2, 8, 9, 10 dhe 12”, masa 8, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pas nënpikës “iii” shtohet nënpika “iv” me këtë përmbajtje:

“iv. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura, me pikë, sipas kriterëve të konkurrueshmërisë. Komisioni bën renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve, nga projektet me pikë maksimale deri tek projektet me pikë minimale dhe ja paraqet drejtorit të përgjithshëm të AZHBR-së, i cili me urdhër shpall listat e projekteve fituese në faqen zyrtare të AZHBR-së. Komisioni e ushtron veprimtarinë në zyrat qendrore të AZHBR-së. Komisioni përfundon procesin e vlerësimit brenda 45 ditëve nga ngritja e tij.”;

b) në titullin e nënpikës “iv”, “Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë numërtimi” “iv” zëvendësohet me “v”.

3. Në kreun VIII, “Kriteret, aplikimi dhe dokumentet e nevojshme për masat 2, 8, 9, 10 dhe 12”, masa 9, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) pas nënpikës “iii”, “Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR”, shtohet nënpika “iv” me këtë përmbajtje:

“iv. Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve bën vlerësimet e kërkesave të paraqitura, me pikë, sipas kriterëve të konkurrueshmërisë. Komisioni bën renditjen e projekteve sipas rendit zbritës të pikëve, nga projektet me pikë maksimale deri tek projektet me pikë minimale dhe ja paraqet drejtorit të përgjithshëm të AZHBR-së, i cili me urdhër shpall listat e projekteve fituese në faqen zyrtare të AZHBR-së. Komisioni e ushtron veprimtarinë në zyrat qendrore të AZHBR-së. Komisioni përfundon procesin e vlerësimit brenda 45 ditëve nga ngritja e tij.”;

b) në titullin e nënpikës “iv” “Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë” numërtimi “iv” zëvendësohet me “v”.

4. Në kreun VIII, “Kriteret, aplikimi dhe dokumentet e nevojshme për masat 2, 8, 9, 10 dhe 12”, masa 10, nënpika “iv”, “Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë”, riformulohet si vijon:

“iv. Transferta

Transferimi i fondit bëhet vetëm nëse shoqëria ka status aktiv në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Përfituesi do të informojë çdo muaj AZHBR-në dhe MBZHR-në për implementimin dhe zbatimin e projektit.

AZHBR-ja dërgon në MBZHR kërkesën për transferimin e fondit përkatës nga llogaria ekonomike 606 “Transferte në buxhetet familjare”, të AZHBR-së në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”, në përputhje me përcaktimet e ligjit organik të buxhetit.

Mbas kalimit të fondit përkatës në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”, AZHBR-ja ekzekuton transferimin e vlerës në përputhje me përcaktimet e ligjit organik të buxhetit.”.

5. Në kreun IX, “Procedurat e aplikimit, përzgjedhjes, verifikimit dhe ekzekutimit të pagesave për masat 2, 8, 9, 10 dhe 12”, pas pikës 10 shtohen pikat 11, 12 dhe 13 me këtë përmbajtje:

“11. Zyra e protokollit të AZHBR-së i dorëzon me procesverbal Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve dosjet e aplikimeve për masat 8 dhe 9, brenda 3 ditë pune nga ngritja e komisionit. Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat e zarfeve të dosjeve të aplikimeve, datën dhe numrin e protokollimit.

12. Përjashtimisht për masën 10 nuk zbatohen parashikimet e pikave 6, 7, 8 dhe 9.

13. Për vlerësimin e aplikimeve për masat 8 dhe 9 në AZHBR para fillimit të shqyrtimeve të aplikimeve ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve me përbërje dy përfaqësues nga AZHBR-ja dhe 3 përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, njëri prej të cilëve caktohet kryetar. Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës i njofton AZHBR-së përfaqësuesit në Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve, brenda 2 ditë pune nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.”.

6. Në kreun XI, “Kontrolli për administrimin e fondit dhe çështje të tjera” në pikën 18, pas togfjalëshit “Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” shtohet togfjalëshi “Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**